

PROCESVERBAL

Bashkia: SKRAPAR

Data: 13.07.2026

Ora: 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve, Bashkia Skrapar

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 6 dhe 23 të tij, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, ligjit nr. 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ligjit 21/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në datën 13.07.2026, në sallën e mbledhjeve, Bashkia Skrapar u zhvillua dëgjesa publike me objekt: **Diskutimi i Draft Planit Vendor të Barazisë Gjinore, Bashkia Skrapar.**

Të pranishëm:

Nën Prefekti

Përfaqësues të Institucioneve Vendore;

Anëtarë të Këshillit Bashkiak;

Përfaqësues të Bashkisë Skrapar;

Qytetar të qytetit të Çorovodës.

Objektivi i dëgjësës

Qëllimi i dëgjësës ishte diskutimi i **Draft Planit Vendor të Barazisë Gjinore, Bashkia Skrapar**, me përfaqësues të institucioneve vendore, qytetarë si dhe dhënia e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga të gjithë aktorët e interesit.

Përmbledhja e diskutimeve

Prezantimi i Planit Vendor të Barazisë Gjinore

Takimi u hap nga Nën Kryetarja e Bashkisë Skrapar Znj. Sonila Hysenbelliu, e cila falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe theksoi rëndësinë e draft planit vendor të barazisë gjinore që lidhet me interesin e komunitetit.

Më pas, fjalën e mori Përgjegjësjë e Shërbimit Social në Bashkinë Skrapar, Znj. Teuta Hysenbelliu, e cila ju prezantoi të pranishmëve, se aktualisht plani vendor i barazisë gjinore ka për qëllim, garantimin e barazisë gjinore, përmirësimin e cilësisë së jetës së grave dhe burrave. Gjithashtu, plani ka perspektiv gjinore në politikat vendore.

Ndër të tjera u theksua roli i Bashkisë në çështjet e dhunës në bazë gjinore, dhe shërbimet për grupet vulnerabël, mbështetje fuqizuese, përmirësim i aksesit si dhe targetim me efektiv.

Vizioni i këtij plani përqendrohet për një bashki gjithëpërfshirëse që gratë dhe burrat të kenë mundësi për trajtim të barabartë, pjesëmarrje e barabartë në vendimmarrje dhe në jetën publike komunitare, fuqizimin ekonomik dhe social i grave nëpërmjet punësimit, sipërmarrjes, aksesit në shërbime cilësore, si dhe një komunitet i sigurt dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë prezantimit u trajtuan objektivat strategjike që ka për qëllim ky plan:

- Fuqizimi ekonomik, parandalimi i dhunës,
- rritja e pjesëmarrësve në vendimmarrje,
- përmirësimi i shërbimeve sociale,
- barazia në arsim si dhe forcimi institucional.

Në përfundim të prezantimit u shpjeguan dhe rekomandimet për këtë draft plan, si më poshtë vijon:

- Investim për fuqizim ekonomik;
- akses më i mirë në zonat rurale;
- bashkëpunim ndërinstitucional, buxhetim gjinor si dhe monitorim i vazhdueshëm.

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani do të përmirësoj mirëqenien dhe zhvillimin vendor.

Pas përfundimit të prezantimit, Nën Kryetarja e Bashkisë ftoi të pranishmit, të shprehnin mendimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me Draft Planin e Brazisw Gjinore.

Nw fjalën e tij, Nënprefekti, Z. Astrit Mustafaj, ngriti shqetësimin në lidhje me strehimin e viktimave në raste kur ka. Gjithashtu, theksoi se nga viti 2024 e në vazhdim raportimi i rasteve të dhunës ka qenë në rënie. Ai ngriti shqetësimin se drejtuesit e institucioneve duhet të jenë të pranishëm në takime, pasi janë aktorët kyç për të marrë një zgjidhje sa më të shpejt.

Më pas, Znj. Klajda Shkëmbi e cila mban detyrën e Shefes së Kujdesit Shëndetësor Parësor, pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Skrapar, ngriti shqetësimin e saj që rastet e dhunës nuk janë në ulje, por nuk raportohen dhe kjo na çon në statistika sikur ne si Bashki, nuk kemi raste dhune.

Znj. Sonila Hysenbelliu vuri theksin se denoncimet kryhen pranë Komisarariatit të Policisë Skrapar, por tërhiqen ditën tjetër po nga vetë të dhunuarat që kërkojnë të pajisen me urdhër mbrojtje.

Z. Eno Kaci, përfaqësues i Zyrës Arsimore në Skrapar shprehu mendimin se këto raste dhe pse bëjnë tërheqjen e denoncimit duhet të ngelen si raste në institucion dhe të janë në mbikëqyrje të vazhduar nga ana e institucioneve.

Znj. Sonila Hysenbelliu shprehu që në momentin që tërhiqet denoncimi dhe nuk vazhdon procedura, pasi rasti quhet i mbyllur dhe nuk ngelet statistikë për institucionin.

Gjithashtu, theksoi që në Buxhetin e vitit 2027 është planifikuar një buxhet i dedikuar për paketën e emergjencës, për viktimat e dhunës (strehimin për 72 orë). Bashkia e ka parashikuar këtë fond, që t'ju vijë në ndihmë personave në nevojë.

Në përfundim, Nënkryetarja Znj. Sonila Hysenbelliu falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin, diskutimet dhe sugjerimet e dhëna.

Bashkëngjitur: Lista e pjesëmarrësve në dëgjuesën publike dhe fotografi.

Mbajtësi i procesverbalit

Specialiste e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës dhe Barazisë Gjinore
Fjorentina Rakipi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Fjorentina Rakipi', with the date '27/12/2026' written above it.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

KONSULTIM PUBLIK, ME OBJEKT: "DISKUTIM I DRAFT PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE"

BASHKIA SKRAPAR

Skrapar më, 13.07.2026

Lista e pjesëmarrësve në konsultim: Përfaqësues institucionesh, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Qytetarë dhe Aktorë të interesuar.

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni	Qyteti / Fshati	Nr. telefonit	Firma
1.	Asprit Mustafa	PREFEKTURA	Çorovod.	0688602034	
2.	Ilirjan Hoxha	Punonjës OSIT E	Potom	0684148465	
3.	Eno Kaci	ZVA Skrapar	Çorovodë	0685086405	
4.	Lorena Hoxha	NJVKSH	Çorovodë	0684448145	
5.	Buriburge Gëçkulli	"Kahreman Ylli"	Çorovodë	0682032143	
6.	Elsa Petritaj	Qytetare e Këshillit	Çorovodë	0695389489	
7.	Alma Kadasi	Anëtare e Këshillit	Çorovodë	0684287808	
8.	Yshendilajt Joxhallari	Anëtar Këshilli	Nj. Adm. Dendhi	0686150666	
9.	Anisa Suba	Qytetare	Çorovodë	0675402189	
10.	Ergista Lamçe	Qytetare	Çorovodë	0683510779	
11.	Jusilda Dymishi	P/Planifikimit të Territorit	Çorovodë	0684574121	
12.	Anisa Kapchis	Qytetare	Çorovodë	0685094013	
13.	Fjorantina Tabipi	PP/Hj. M. B	B. Skrapar	0692327455	
14.	Romela Mako	KVDH	B. Skrapar	0685127449	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

KONSULTIM PUBLIK, ME OBJEKT: "DISKUTIM I DRAFT PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE"

BASHKIA SKRAPAR

Skrapar më, 13.07.2026

Lista e pjesëmarrësve në konsultim: Përfaqësues institucionesh, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Qytetarë dhe Aktorë të interesuar.

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni	Qyteti / Fshati	Nr. telefonit	Firma
1.	Xheni Celo	Sek Këshillit Bashku	Çorovodë	0675405816	
2.	Diana Koci	Qytetare	Çorovodë	0697407003	
3.	Kajlimë Samshaku	Qytetare	Çorovodë	0686537488	
4.	Lamir Zaimi	Qytetare	Çorovodë	0683822281	
5.	Hernando Sinoraj	Qytetare	Çorovodë	0682567189	
6.	Mirela Sinoraj	Qytetare	Çorovodë	0688033075	
7.	Mbarime Molla	Qytetare	Çorovodë	0688830446	
8.	Bashk Damsko	N. SH. Pjion	Çorovodë	0685209345	
9.	Vijon Shupri	B. Skrapar	Çorovodë	0682051532	
10.	Nedim Khasi	B. Skrapar	Çorovodë	0697316006	
11.	Aznaida Hatellari	Bashkia Skrapar	Çorovodë	0696442923	
12.	Sonila Hyrumbelli	Bashkia Skrapar	Çorovodë	0682550716	
13.	Teuta Hyrumbelli	Bashkia Skrapar	Çorovodë	0688616756	
14.	Elir Molla	Qytetar	Çorovodë	0682414481	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

KONSULTIM PUBLIK, ME OBJEKT: "DISKUTIM I DRAFT PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE"

BASHKIA SKRAPAR

Skrapar më, 13.07.2026

Lista e pjesëmarrësve në konsultim: Përfaqësues institucionesh, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Qytetarë dhe Aktorë të interesuar.

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni	Qyteti / Fshati	Nr. telefonit	Firma
1.	Markelion Kuhu	Qytetar	Forovod	069 666 00 67	
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					